



Partnerët-Shqipëri, Qendra për
Ndryshim dhe Menaxhim Konflikti

VLERËSIMI I KAPACITETEVE ADVOKUESE TË SEKTORIT TË OJF-ve SHQIPTARE

RAPORT KOMBËTAR

Janar 2005

Drejtuese

Juliana Hoxha

Grupi i Vëzhgimit

Jonida Alite

Suzana Liko

Elona Muça

Elona Kapexhiu

Juliana Hoxha

Elira Jorgoni

Grupi i Administrimit të të Dhënave

Elona Kapexhiu

Juliana Hoxha

Grupi i Analizimit të të Dhënave dhe Hartimit të Raportit

Juliana Hoxha

Klotilda Tavani

Arjola Agolli

Elona Kapexhiu

Ky botim u bë i mundur nëpërmjet mbështetjes së siguruar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) nën termat të CA 182-A00-04-00104-00. Opinionet e shprehura këtu janë ato të autorëve dhe nuk reflektojnë detyrimisht këndvështrimin e USAID.

Botues:

Partnerët – Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti

Të gjitha të drejtat e autorit janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij libri nuk mund të riprodhohet, të kopjohet në cdo lloj forme ose me cdo lloj mjeti elektronik, mekanik, pa pasur më parë lejen me shkrim të Partnerëve – Shqipëri.

Për të siguruar një kopje të këtij botimi, kontaktoni Partnerët – Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti, Rruga Pjetër Bogdani, Nr. 41, Tiranë, Shqipëri

MIRËNJOHJE DHE VLERËSIM

Partnerët - Shqipëri shpreh mirënjohje dhe vlerësim të thellë për të gjithë individët dhe organizatat që morën pjesë në këtë studim duke i kushtuar atij kohën dhe vëmendjen e nevojshme. Ky studim do të ishte i pamundur pa mbështetjen dhe informacionin e ofruar prej tyre.

Një falenderim i veçantë i shkon shoqatës “Unë, Gruaja” në Pogradec, Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile në Korçë dhe Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile në Vlorë të cilat mbështetën anën organizative të gjithë procesit të mbledhjes së të dhënave në terren.

PËRMBAJTJA

I. HYRJE	7
II. PËRSHKRIM I PARTNERËVE - SHQIPËRI	8
III. NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHEM I SEKTORIT TË OJF-ve NË SHQIPËRI	10
IV. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT	12
V. REZULTATET E VLERËSIMIT	16
V. a. Përfshirja e OJF-ve në aktivitete advokacie	16
V. a. 1. Përfshirja në procesin zgjedhor	16
V. a. 2. Përfshirja në iniciativa antikorrupsion	18
V. b. Kapaciteti Organizativ	20
V. b. 1. Sistemet dhe procedurat organizative	20
V. b. 2. Burimet njerëzore	21
V. b. 3. Kapacitetet infrastrukturore	25
V. c. Qëndrueshmëria financiare	26
V. c. 1. Sistemet financiare dhe kapaciteti manaxhues	26
V. c. 2. Burimet e financimeve për vitin 2004	27
V. c. 3. Pengesat në sigurimin e fondeve	29
V. d. Kapacitetet advokuese	29
V. d. 1. Komunikimi me vendimmarrësit	30
V. d. 2. Përfshirja e anëtarëve në fushatat e advokacisë	32
V. d. 3. Formimi i koalicioneve për promovimin e interesave të përbashkëta	33
V. d. 4. Lobimi	34
V. e. Imazhi publik	34
V. e. 1. Kodi i Etikës	34
V. e. 2. Qëndrimi i qeverisë ndaj sektorit të OJF-ve	35
V. e. 3. Marrëdhëniet me Median	37
VI. KONKLUZIONE	39
VII. REKOMANDIME	41
VIII. SHTOJCAT	
VIII.1 Lista e qyteteve që përfshihen në secilën nga zonat gjeografike të përdorura në studim	43
VIII.2 Lista e organizatave pjesëmarrëse në studim	45

I. HYRJE

Partnerët - Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti, në kuadër të programit Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri (DQSH), ka realizuar vlerësimin e kapaciteteve advokuese të sektorit të OJF-ve Shqiptare. Programi DQSH, i financuar nga USAID dhe i implementuar nga tre organizata partnere: Instituti Demokratik Amerikan (NDI), Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti dhe Bordi Ndërkombëtar për Shkëmbime dhe Kërkime (IREX), ka për qëllim të promovojë qeverisjen e mirë, pjesëmarrjen aktive qytetare në proceset politike dhe elektorale dhe luftën kundër korrupsionit në Shqipëri.

Qëllimi i këtij vlerësimi është të analizojë kapacitetet institucionale të OJF-ve që punojnë në fushën e advokatisë, e parë kjo në aspektin e mobilizimit të anëtarëve dhe mbështetësve si pjesë e proceseve vendimmarrëse ekonomike dhe politike; kapacitetit organizativ dhe financiar për të mbështetur çështje me interes të përbashkët në mjedisin social, politik dhe ekonomik ku ato veprojnë; qëndrimit të institucioneve qeveritare dhe mbështetjes së tyre ndaj sektorit të OJF-ve si dhe aksesit e marrëdhënieve të OJF-ve me median.

Konkluzionet e vlerësimit, si dhe rekomandimet përkatëse do të shërbejnë si pika referimi për hartimin e programeve të përshtatshme të trainimit dhe të asistencës që P-Sh do të ofrojë për sektorin e OJF-ve lokale shqiptare në kuadër të programit DQSH. Përveç kësaj, informacioni i mbledhur gjatë vlerësimit do të shërbejë për prodhimin e një versioni të rishikuar të adresarit të OJF-ve në Shqipëri, pjesë e punës së Partnerëve - Shqipëri si qendër burimore dhe informacioni për sektorin e OJF-ve.

II. PËRSHKRIM I PARTNERËVE - SHQIPËRI

Partnerët - Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti është një OJF e pavarur shqiptare me mision zhvillimin e shoqërisë civile dhe të një kulture ndryshimi dhe manaxhimi të konfliktit në Shqipëri.

Partnerët - Shqipëri (P-Sh) është anëtare e Partnerëve për Ndryshim Demokratik Ndërkombëtar, një rrjet i përbërë nga 15 qendra të pavarura i ngritur në fillim të viteve '90 në Evropën Qëndrore dhe Juglindore, Amerikën Latine dhe në Lindjen e Mesme. Qysh prej janarit 2006 rrjeti është rregjistruar në Belgjikë si shoqatë me anëtarësi, me një zyrë pune në Bruksel.

Fushat tematike të punës së Partnerëve për Ndryshim Demokratik Ndërkombëtar janë: qeverisja e mirë, shoqëria civile, pushteti vendor, zhvillimi i qëndrueshëm.

Partnerët-Shqipëri si pjesë e këtij rrjeti ka dizenuar dhe po zbaton një seri programesh në mbështetje të misionit të saj. Këto programe konsistojnë në:

- Fuqizimin e kapaciteve të sektorit jo-fitimprurës. Partnerët-Shqipëri ka hartuar dhe po zbaton programe trainimi dhe asistence teknike për sektorin e OJF-ve në fusha të ndryshme si zhvillim organizativ, manaxhim ndryshimi, advokasi, krijimi i koalicioneve, qeverisje me pjesëmarrje dhe planifikim kooperues.
- Hartimin dhe zbatimin e proceseve me pjesëmarrje rreth fushave të mëdha tematike si zgjedhjet politike në vend, iniciativa që synojnë reduktimin dhe parandalimin e korrupsionit, zhvillimi i kuadreve ligjore për grupe të ndryshme interesi.
- Përmirësimin e kuadrit ligjor për sektorin e OJF-ve që synon plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit rregullator ekzistues, me fokus të veçantë në çështjet financiare dhe fiskale.
- Rritjen e kapaciteteve të pushtetit vendor dhe nxitjen e pjesëmarrjes qytetare në vendimarrje përmes përmirësimit të aftësive drejtuese dhe manaxhuese të aktorëve lokal, krijimin e modeleve bashkëpunuese për rritjen e

pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe promovimin e praktikave më të mira të qeverisjes në nivel kombëtar dhe rajonal.

- Fuqizimin e rolit drejtues të rinisë dhe gruas në mbështetje të përfshirjes së tyre aktive në jetën ekonomike dhe politike në vend.

Falë eksperiencës dhe ekspertizës së saj në sektorin e OJF-ve, Partnerët - Shqipëri ka arritur të jetë pjesë e partneriteteve dhe rrjeteve kombëtare e ndërkombëtare në implementimin e programeve të ndryshme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Në këtë kuadër, Partnerët - Shqipëri aktualisht është pjesë e Konsorciumit për Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri (DQSH) dhe Rrjetit për Shoqërinë e Hapur për Shqipërinë (NOSA).

P-Sh ka një rrjet të gjërë partnerësh dhe donatorësh, përfshirë këtu: USAID, Banka Botërore dhe Instituti i Bankës Botërore, Komisioni European, Agjencia Kanadeze për Zhvillim Ndërkombëtar, Fondacioni i Shoqërisë së Hapur në Shqipëri, UNDP, Medicos Del Mundo, Handicap Internacional, Deutsche Welthungerhilfe, Olaf Palme, World Learning, IREX dhe organizata të tjera lokale e ndërkombëtare.

III. NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I SEKTORIT TË OJF-VE NË SHQIPËRI

Shoqëria civile¹ dhe organizimet e ndryshme brenda saj luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimet ekonomike, sociale dhe politike në vend nëpërmjet ndërtimit të konsensusit publik, nxitjes së pjesëmarrjes së publikut në hartimin dhe zbatimin e reformave publike duke zhvilluar kështu ndjenjën e pronësisë, ofrimit të një game të gjerë shërbimesh, përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënies në sektorin publik.

Që prej vitit 1990, kohë kur e drejta e shoqërizimit e shprehur në krijimin e OJQ-ve të para filloi të ushtrohej lirisht, shoqëria civile shqiptare ka bërë hapa të rëndësishëm në fushën e ofrimit të shërbimeve për publikun e gjerë dhe grupet në nevojë; në hartimin, propozimin dhe lobimin e ligjeve dhe politikave në nivel kombëtar dhe lokal si Kushtetuta e Shqipërisë, Strategjia Kombëtare për Zhvillim Social Ekonomik, Strategjia për Decentralizimin e Pushtetit Vendor, etj; në fushën e kërkimit dhe dokumentimit; atë të monitorimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përfshi këtu edhe votën e lirë; dhe në vitet e fundit luftën kundër trafikimit dhe korrupsionit.

Ligji i ri i OJF-ve i aprovuar në vitin 2001, është konsideruar si i përparuar, duke vendosur bazat për zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë civile në Shqipëri.

Veçanërisht vitet e fundit është vënë re një rritje e dukshme e numrit të Organizatave Jofitimprurëse në Shqipëri, e shoqëruar kjo me një shumëllojshmëri të shpërndarjes sektoriale.

Prezenca e shoqërisë civile në mbrojtjen e çështjeve publike ka qenë gjithnjë e më e dukshme. Presioni nga ana e sektorit është konsideruar si një hap pozitiv në influencimin e ndërgjegjësimit të opinionit publik dhe të inkurajimit të përfshirjes qytetare për më shumë pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse. Kjo është parë si një mundësi nga ana e qytetarëve për të shprehur shqetësimet dhe problemet e tyre, duke u përfshirë për herë të parë në protesta publike me motiv jopolitik. Kjo prezencë është vënë re edhe në luftën kundër

¹ Shoqëria civile përcaktohet si sfera jashtë familjes, shtetit dhe tregut, dhe përjashton bizneset fitimprurëse, ndonëse shoqatat profesionale mund të jenë pjesë e saj. Këto organizata, të cilat përfshijnë sindikatat, organizatat me bazë komunitare, institucionet e besimit, organizatat bamirëse, fondacionet, organizatat e studentëve, lëvizjet sociale, shoqatat profesioniste dhe shumë të tjera, referohen gjithashtu si organizata të shoqërisë civile", *Mjedisi Ligjor dhe Rregullator për Shoqërinë Civile dhe Angazhimin Qytetar në Shqipëri*, May 2004, Banka Botërore në Washington

korrupsionit ku OJF të ndryshme apo koalicione OJF-sh janë bërë pjesë e fushatave në mbrojtje të interesave qytetare të prekura nga ky fenomen.

Në krahasim me vitet e mëparshme, OJF-të bashkëpunojnë më shumë me njëra-tjetrën, me strukturat qeverisëse, me median dhe në disa raste edhe me bizneset. Megjithatë, ende vihen re vështirësi në ndërtimin e partneriteteve të qëndrueshme dhe ndarjen e përgjegjësi në mënyrë të drejtë ndërmjet aktorëve, ngritjen e strukturave advokuese dhe disa herë edhe në shpërndarjen e informacionit. Këto vështirësi shpesh herë shkaktohen nga kapacitetet e pamjaftueshme të palëve për të përkthyer çështje të ndryshme interesi në qëllime të përbashkëta. Në këtë kontekst ka vështirësi edhe brenda sektorit të OJF-ve. Pavarësisht disa përpjekjeve të përbashkëta në mbrojtjen e çështjeve të rëndësishme, pak OJF ndajnë informacion më njëra-tjetrën, edhe nëse janë pjesë e rrjeteve apo koalicioneve të përbashkëta. Mosbesimi midis OJF-ve ende ekziston.

Përgjithësisht OJF-të, sidomos ato jashtë kryeqytetit, nuk kanë strategji afatgjata dhe sisteme për të zhvilluar programe të cilat kontribuojnë në arritjen e këtyre strategjive. Varësia pothuajse e plotë e sektorit të OJF-ve nga financimet e huaja, e bën atë të paqëndrueshëm institucionalisht dhe kufizon aftësitë e sektorit për t'iu përgjigjur nevojave të grupeve të tyre të interesit. Kjo përbën një nga sfidat më të mëdha për të ardhmen e qëndrueshme të sektorit të OJF-ve në Shqipëri.

IV. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

Për të realizuar këtë studim Partnerët – Shqipëri u fokusua fillimisht në identifikimin e organizatave që kryejnë aktivitete në fushën e advokasisë. Si burim informacioni shërbeu pikë së pari banka e të dhënave që Partnerët – Shqipëri disponon e zhvilluar dhe pasuruar ndër vite, si dhe adresarët dhe publikimet e ndryshme të institucioneve të tjera donatore, organizatave ombrellë dhe institucioneve të tjera.

Në vend mungojnë statistika të besueshme mbi numrin dhe shtrirjen gjeografike të sektorit jo-fitimprurës në Shqipëri. Ndonëse numri i OJF-ve në vend sipas raporteve të ndryshme varion nga 800 në 1000, puna në terren e Partnerëve – Shqipëri për kryerjen e dy sondazheve (2001 dhe 2004) ka treguar se vetëm një grup i vogël OJF-sh, rreth 200 prej tyre, janë të pranishme me aktivitetin e tyre në komunitet. Për këtë arsye P-Sh beson se kampioni prej 131 OJF të intervistuar krijon mundësi për një analizë reale dhe konkluzione të bazuara rreth statusit të sektorit të OJF-ve dhe kapaciteteve të tyre për t'u përfshirë në iniciativa advokacie.

Me qëllim arritjen e një rezultati sa më objektiv dhe gjithëpërfshirës, përzgjedhja e kampionit dhe shpërndarja e tij u bazua në disa kriteret e cilat janë: misioni i OJF-ve, shpërndarja gjeografike, forma e organizimit, mosha (gjatësia e jetës organizative), si dhe fusha e veprimtarisë së OJF-ve.

Sipas kriterëve, kemi një pasqyrë të tillë të shpërndarjes së kampionit:

Misioni i OJF-ve. Nga organizatat e identifikuar, u përzgjedh një numër prej 167 OJF-sh, të cilat kanë si pjesë të misionit të tyre përfshirjen në aktivitete advokacie. Vështirësia e punës në terren bëri që nga kampioni i përzgjedhur të mund të intervistohen vetëm 131 OJF.

Shpërndarja gjeografike e OJF-ve. Kampioni u nda sipas katër zonave të mëposhtme gjeografike², të njëjta me ato të përdorura në studimin e vitit 2001.

Tiranë	38 %	Jug	34 %
Qendër	13 %	Veri	15 %

² Shih Shtojcën 1 për një pasqyrë të plotë të qyteteve që përfshihen në secilën prej katër zonave gjeografike.

Mosha e OJF-ve. Në këtë vlerësim u intervistuan organizata me moshë të ndryshme për të parë sesa kjo ndikon në kapacitetin e organizatave të angazhuara në fushën e advokatisë.

15 – 10 vjet	16 %
9 – 5 vjet	59 %
OJF të regjistruara pas vitit 2001 ³	25 %

Forma e organizimit të OJF-ve. Klasifikimi i kampionit sipas formës së organizimit u bazua në vetë-deklarimet e OJF-ve të intervistuar⁴.

Shoqata	69 %
Fondacione	16 %
Qendra	15 %

Fusha e veprimtarisë së OJF-ve. Organizatat e përfshira në vlerësim, kanë identifikuar 12 fusha veprimtarie, dhe secila prej OJF-ve ka përzgjedhur më shumë se një fushë, fakt që reflektohet edhe në përqindjet e mëposhtme.

Të Drejtat e Njeriut	60 %	Rritja Ekonomike	29 %
Rinia	58 %	Arsimi	25 %
Demokracia	55 %	Shëndeti	25 %
Shërbimet Sociale	48 %	Fëmijët	12 %
Gruaja	46 %	Bujqësia	9 %
Mjedisi	32 %	Infrastruktura	6 %

Mbledhja e Informacionit

Për të mbledhur informacionin e nevojshëm nga kampioni, në vlerësim u përdor teknika e intervistimit bazuar në një pyetësor të hartuar paraprakisht. Pyetësori përmbante kryesisht pyetje të mbyllura dhe ndahej në pesë seksione pyetjesh të kategorizuara si më poshtë:

- Identiteti i organizatës
- Kapaciteti organizativ

³ Në Maj 2001 hyri në fuqi ligji i ri mbi organizimin e Organizatave Jo-fitimprurese (OJF). Me anë të këtij studimi bëhet një përpjekje për të parë sesa ky kuadër i ri ligjor ka efektuar mënyrën e organizimit dhe funksionimit të OJF shqiptare.

⁴ Një pjesë e konsiderueshme e OJF-ve të intervistuar të cilat sipas ligjit të vitit 2001 duhet të jenë të regjistruara si Qendra, kanë ruajtur formën e vjetër të organizimit si Fondacion. Për këtë arsye numri i Fondacioneve është pothuajse i barabartë me atë të Qendrave, por që nuk do të thotë se ato kryejnë aktivitet grantdhënës.

- Kapaciteti financiar
- Kapaciteti advokues
- Imazhi publik

Testimi i Pyetësorit

Para aplikimit të metodologjisë, P-Sh testoi qartësinë e përmbajtjes së pyetësorit si dhe kohën e nevojshme për plotësimin e tij me një grup përfaqësuesish nga sektori i OJF-ve. Mbi bazën e mendimit të mbledhur, pyetësori u ripunua.

Përzgjedhja e të Intervistuarve

Intervistat u zhvilluan individualisht, kryesisht me Drejtorin Ekzekutiv ose Kryetarin e Bordit të organizatës dhe në mungesë të tyre me anëtarë të stafit apo anëtarë të Bordit Drejtues të organizatës.

Kohëzgjatja e Intervistës

Periodha e intervistimit zgjati rreth tetë javë, gjatë muajve Nëntor-Dhjetor 2004. Çdo intervistë zgjati mesatarisht një orë.

Shtrirja Gjeografike

Administrimi i pyetësorëve u krye në gjashtë qytete, të cilat shërbyen si qendra për realizimin e intervistave rajonale me një mbulim gjeografik në shkallë kombëtare. Përzgjedhja e tyre u bazua në dy faktorë kryesorë: (1) pozita e përshtatshme gjeografike, e cila mundësonte pjesëmarrjen në proces të organizatave të zonave përreth dhe (2) lehtësirat në infrastrukturë që mundësonin procesin. Gjashtë qytetet që shërbyen si qendra ishin:

Tirana	(me mbulim Durrësin, Elbasan)
Shkodra	(me mbulim Hasin, Burrelin, Pukën, Kukësin, Peshkopinë)
Fieri	(me mbulim Lushnjën, Beratin, Kuçovën)
Vlora	(me mbulim Himarën)
Korça	(me mbulim Pogradecin, Librazhdin)
Gjirokastra	(me mbulim Sarandën, Përmetin).

Ndërkohë, P-Sh ndërtoi një bazë të dhënash me qëllim manaxhimin dhe përpunimin e informacionit të mbledhur. Gjetjet e prezantuara në këtë raport janë bazuar vetëm në këto të dhëna.

Si çdo proces, edhe ky vlerësim hasi në disa vështirësi, të cilat u identifikuan para dhe gjatë punës për mbledhjen e informacionit në terren, si:

- Mungesa e një burimi të saktë dhe të besueshëm informacioni mbi numrin, shpërndarjen gjeografike dhe fushat e veprimit të OJF-ve lokale shqiptare;
- Mungesa e mjeteve të komunikimit me një pjesë të organizatave të përzgjedhura, veçanërisht ato jashtë Tiranës;
- Pamundësia e identifikimit në terren të disa organizatave që aktualisht ofronin shërbimet e tyre në komunitet;
- Realizimi i disa intervistave me persona që nuk kishin informacion të plotë mbi veprimtarinë e organizatës për shkak të pozitës së tyre manaxhuese.

Pikërisht, ekzistenca e këtyre pengesave çoi në zvogëlimin e kampionit nga 167 OJF të përzgjedhura fillimisht, në 131 OJF.

V. REZULTATET E VLERËSIMIT

V. a. Përfshirja e OJF-ve në aktivitete advokacie

Është e rëndësishme të theksohet se rezultatet e këtij vlerësimi janë të bazuara vetëm në të dhënat e mbledhura nga kampioni i përbërë prej 131 OJF shqiptare.

Nga të dhënat e sondazhit rezulton se nga i gjithë kampioni, organizatat që punojnë në fushën e Demokracisë dhe të të Drejtave të Njeriut kanë qenë më shumë të përfshira në iniciativa advokacie dhe aktivitete të tilla si influencimi i politikave qeverisëse dhe mobilizimi i komunitetit në mbrojtje të çështjeve të ndryshme që prekin komunitetin. Pavarësisht fokusit të tyre të punës dhe organizimit të aktiviteteve të tjera, OJF-të shqiptare vazhdojnë të mbeten në thelb organizata që ofrojnë shërbime sociale për komunitetin.

Nga sondazhi vihet re se organizatat e vlerësojnë të rëndësishme përfshirjen e komunitetit në fushatat e advokacisë, pasi shumica e organizatave që punojnë në fushën e demokracisë, të rinisë, të të drejtave të njeriut, të shërbimeve sociale, të të drejtave të gruas vlerësojnë si aktivitet kryesor të punës së tyre mobilizimin e komunitetit.

Programi Demokraci dhe Qeverisje ka për fokus të punës së tij fuqizimin e rolit të shoqërisë civile në proceset zgjedhore si dhe në reduktimin e korrupsionit në vend. Për këtë arsye në këtë sondazh i është kushtuar një vëmendje e vecantë këtyre dy aktiviteteve.


V. a. 1. Përfshirja në procesin zgjedhor

Programi Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri e konsideron përfshirjen e sektorit të OJF-ve në zgjedhjet lokale dhe qendrore si një kontribut të rëndësishëm për një proces të lirë dhe të ndershëm zgjedhor.


Aktualisht, ka një eksperiencë të përfshirjes së OJF-ve në proceset zgjedhore, që tregohet edhe nga të dhënat e pyetësorit ku rezulton se 35% e organizatave të intervistuar janë përfshirë në proceset zgjedhore.

Krahas rezultateve të dukshme që prezanton Grafiku 1 në lidhje me përfshirjen në aktivitetet kryesore zgjedhore, vihet re se organizatat përfshihen në një përqindje të madhe në aktivitetet para ditës së zgjedhjeve siç mund të jenë *edukimi i votuesve* apo organizimi i *debateve me kandidatët*, krahasuar me ato gjatë dhe pas ditës së zgjedhjeve, deri në momentin e shpalljes së fituesve. I njëjti fenomen ndodh dhe me monitorimin e medias, siç mund të vihet re edhe nga grafiku.

Nga sondazhi rezulton se nuk ka një përfshirje uniforme të sektorit të OJF-ve në proceset zgjedhore, bazuar në pozicionin gjeografik të tyre. Kështu, nga të gjitha organizatat e përfshira, 46% e tyre janë të lokalizuara në Tiranë. Ky fakt ndikon në një masë të konsiderueshme të dhënat që vijnë nga i gjithë kampioni i përzgjedhur në të gjithë territorin e Shqipërisë, siç shihet edhe nga Grafiku 1.



Sondazhi paraqet një disbalancë të përfshirjes së OJF-ve në aktivitetet që lidhen me procesin zgjedhor në vartësi të formës së organizimit. Siç mund të shihet edhe në Grafikon 2, Shoqatat krahasuar me Qendrat dhe Fondacionet përfshihen shumë më tepër në aktivitetet zgjedhore, madje ka aktivitete të cilat realizohen ekskluzivisht nga shoqatat, siç është trainimi i komisionerëve të qendrave zgjedhore.



V. a. 2. Përfshirja në iniciativa antikorrupsion

Përfshirja më e madhe e sektorit të OJF-ve në iniciativa që synojnë reduktimin e praktikave korruptive dhe në proceset e monitorimit të zbatimit të ligjeve në vend, është një nga mënyrat kryesore nëpërmjet të cilës programi DQSH synon të asistojë sektorin e OJF-ve.


Vitet e fundit është vënë re një rritje e përpjekjeve të OJF-ve për t'u përfshirë në iniciativa kundër korrupsionit. Pavarësisht se përpjekjet e tyre në disa raste kanë rezultuar në fushata të suksesshme për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi çështjet e korrupsionit, roli i sektorit të OJF-ve në luftën antikorrupsion mbetet në nivele të ulëta. Një ndër treguesit është niveli i njohurive që ka sektori mbi strukturat dhe platformat e qeverisë për të luftuar korrupsionin.

Nga vlerësimi, rezulton se 66.4%⁵ e OJF-ve kanë dijeni për ekzistencën e strukturës qeveritare antikorrupsion në Shqipëri, por vetëm 38% prej tyre e njohin planin e saj të veprimit. Organizatat që pohojnë se e kanë këtë lloj informacioni, janë ato që pohojnë edhe faktin tjetër që lidhet me përfshirjen e tyre direkte në iniciativa antikorrupsion. Kështu, nga 67.1% e organizatave të intervistuar që pohojnë se janë përfshirë në aktivitete antikorrupsion, 83% e tyre kanë informacion rreth strukturës qeveritare antikorrupsion në Shqipëri. Kjo njohje lidhet me domosdoshmërinë e bashkëpunimeve ndër-sektoriale për arritjen e rezultateve pozitive në iniciativat e ndryshme që synojnë zbutjen e korrupsionit në Shqipëri.


Fushat kryesore të aktivitetit të OJF-ve në proceset antikorrupsion rezultojnë të jenë *edukimi dhe mobilizimi qytetar* për çështjet që lidhen me fenomenin e korrupsionit dhe luftën ndaj tij, pavarësisht ndarjes së tyre gjeografike apo formës së organizimit.

Të dhënat e sondazhit lidhur me përfshirjen e sektorit të OJF-ve në iniciativa antikorrupsion në rajonet e ndryshme të Shqipërisë përforcojnë faktin se organizatat që veprojnë në Tiranë janë më aktive, veçanërisht në procesin e hartimit të ligjeve që lidhet dhe me aksesin më të madh të tyre në strukturat ligjvënëse. Organizatat nga veriu janë shumë pak të përfshira (5 %) në iniciativat antikorrupsion, veçanërisht në ato aktivitete që lidhen me monitorimin e punës së institucioneve shtetërore (Grafiku 3).

⁵ Në kohën e realizimit të vlerësimit, në Shqipëri funksiononte një strukturë qeveritare e quajtur Komisioni Qeveritar i Luftës kundër Korrupsionit pranë zyrës së Kryeministrit. Platforma antikorrupsion i referohet platformës së qeverisë së viteve 2001-2004.



Përveç aspektit gjeografik, përfshirja në aktivitete antikorrupsion lidhet edhe me formën e organizimit të OJF-ve (Grafiku 4). Bazuar në këtë kriter, sondazhi tregon se forma e organizimit ndikon në përqindjet e përfshirjes në aktivitete të ndryshme. Kështu, përveç përfshirjes në përqindje pothuajse të njëjta në aktivitete që synojnë edukimin dhe mobilizimin e qytetarëve, nga grafiku i mëposhtëm vihet re se Fondacionet ofrojnë më tepër asistencë ndaj qeverisë në çështjet e luftës ndaj korrupsionit, krahasuar me Qendrat dhe Shoqatat.



V. b. Kapaciteti Organizativ

Një nga objektivat kryesorë të këtij sondazhi është të vlerësojë kapacitetet organizative të sektorit të OJF-ve të angazhuara në aktivitete advokacie, si një faktor i rëndësishëm që ndikon në nivelin e përfshirjes dhe suksesin e fushatave të advokacisë.

Në vlerësimin e kapaciteteve organizative janë analizuar elementë të tillë si:

- Sistemet dhe procedurat organizative
- Burimet njerëzore
- Kapacitetet teknike

Një vlerësim të tillë P-Sh e ka realizuar edhe në vitin 2001, ku për herë të parë u bë një analizë e plotë e kapaciteteve të sektorit të OJF-ve shqiptare. Nëse krahasojmë të dhënat e sondazheve, vihen re përgjithësisht ndryshime pozitive në disa drejtime të kapaciteteve organizative të OJF-ve.

V. b. 1. Sistemet dhe procedurat organizative

Nga të dhënat e sondazhit rezulton se një përqindje më e lartë e organizatave shqiptare tashmë operojnë mbi bazën e sistemeve dhe procedurave organizative.

Po t'i referohemi hartimit të **Planit Strategjik** si një tregues i kapacitetit organizativ, në vlerësimin e vitit 2001 më pak se 50% e kampionit prej 130 OJF pohonin se e kishin një të tillë, ndërkohë që në vlerësimin aktual 75% e OJF-ve pohojnë se kanë një plan strategjik. Plani strategjik duket se është një dokument i vlefshëm brenda organizatës, po t'i referohemi faktit se 94% e kampionit që e kanë një të tillë, pohojnë se e përdorin në procesin e vendimmarrjes brenda organizatës. Vendimet për të cilat organizatat e pyetura shprehen se e përdorin më shpesh planin strategjik, lidhen me përcaktimin e programeve dhe projekteve të ardhshme (98% e kampionit); strategjitë e ngritjes së fondeve (70.5% e kampionit) dhe mobilizimin e burimeve (69% e kampionit).

Një tjetër element shumë i rëndësishëm i punës së organizatave, është dhe hartimi i **Planeve Vjetore të Punës**. Të pyetura për këtë element, 89% e organizatave të intervistuar shprehen se e ushtrojnë aktivitetin e tyre bazuar në plane pune, por vetëm 6% e tyre pohojnë se kohëzgjatja e planeve të punës është një vjeçare. Ndërkohë, shumica e organizatave veprojnë me plane afatshkurtra nga një në gjashtë mujore, apo mbi bazën e planeve të projekteve individuale. Pra në përgjithësi planet afatgjatë në nivel organizate mungojnë.

Përsa i përket **Sistemeve të Monitorimit**, 73 % e organizatave të intervistuar pohojnë se kur flasin për sisteme monitorimi, më tepër u referohen teknikave të thjeshta të adoptuara në kuadër të kërkesave dhe raportimit tek donatorë të ndryshëm. Në këtë drejtim, sektori është ende larg ngritjes së sistemeve të mirëfillta të monitorim-vlerësimit, si mjete për të evidentuar arritjet e punës së tyre, për të raportuar rezultatet, si dhe për të adoptuar ndërhyrjet e ardhshme në komunitet.

V. b. 2. Burimet njerëzore

Qëndrueshmëria dhe performanca e suksesshme e çdo organizate, për rrjedhojë edhe përfshirja e tyre në aktivitete advokacie, është e lidhur ngushtë me zhvillimin e burimeve njerëzore të organizatës. Kjo është arsyeja që analiza e burimeve njerëzore të sektorit të OJF-ve shqiptare që punojnë në fushën e advokacisë, zë një vend të veçantë në këtë sondazh.


Burimet njerëzore brenda organizatës, në këtë sondazh janë analizuar të ndara në tre kategori:

- Staf me kohë të plotë;
- Staf me kohë të pjesshme;
- Vullnetarë.


Le të shikojmë më poshtë se si paraqitet gjendja për të treja këto kategori.

Stafi me kohë të plotë. Nga të dhënat e sondazhit rezulton se numri i stafit me kohë të plotë, i punësuar në organizatat shqiptare që punojnë në fushën e advokacisë, varion nga 0-92, me një mesatare prej katër staf me kohë të plotë. Për t’u theksuar është fakti që 40% e organizatave të intervistuar pohojnë se nuk kanë asnjë person të punësuar me kohë të plotë, që është një tregues i qartë i kapaciteteve të ulëta njerëzore të këtyre organizatave.

Kapacitetet e ulëta, të paktën në drejtim të numrave vihen re veçanërisht në organizatat që kryejnë aktivitetet e tyre jashtë Tiranës (Grafiku 5) Një fenomen i tillë vërehet kryesisht në shoqatat e Qendrës dhe të Veriut. Shpesh herë në këto organizata gjejmë të punësuar vetëm një person, i cili luan role të shumëfishta brenda organizatës si: Drejtor ekzekutiv, Manaxher projekti, Administrator etj. Kjo është një ndër arsyet që kufizon përfshirjen e tyre në aktivitete advokacie.




Diferenca në këtë drejtim vërehen edhe në ndarjen sipas formës së organizimit të OJF-ve (Grafiku 6). Siç shihet në grafikun e mëposhtëm, pothuajse gjysma e Shoqatave dhe Fondacioneve kanë 1-3 anëtarë stafi me kohë të plotë. Ndryshe paraqitet pamja për Qendrat tek të cilat mbizotëron intervali 4-6 anëtarë stafi me kohë të plotë, që do të thotë që në aspektin e kapaciteteve njerëzore Qendrat janë më të favorizuara për t'u përfshirë në aktivitete advokacie.




Stafi me kohë të pjesshme. Një përqindje e lartë e kampionit (60%) nuk kanë asnjë staf me kohë të pjesshme. Ndërkohë pjesa tjetër e kampionit paraqitet e tillë: 33% kanë 1 deri në 2 staf me kohë të pjesshme dhe për 7% varion nga 3 – 66 staf.

Sondazhi tregon se ka rritje të numrit të stafit me kohë të pjesshme krahasuar me stafin me kohë të plotë, veçanërisht për intervalet 7-10 dhe më shumë se 10 staf. Kjo vihet re dukshëm sidomos për organizatat të cilat punojnë jashtë Tiranës.



I njëjti fenomen ndodh edhe me të dhënat e stafit me kohë të pjesshme sipas formës së organizimit të OJF-ve (Grafiku 8) Kështu, përsëri Fondacionet dhe Shoqatat kanë më shumë staf me kohë të pjesshme në intervalin 1-3, por ka një rritje të ndjeshme të numrit të stafit brenda këtij intervali për Qendrat. Ndërkohë që janë Shoqatat ato që paraqiten me më shumë staf me kohë të pjesshme në nivelet 7-10 dhe më shumë se 10.





Kontrata e punës. Kontrata e punësimit është një tjetër element i rëndësishëm që përcakton kapacitetet njerëzore brenda organizatës. Kohëzgjatja e kontratës së punës së stafit lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me natyrën e punës së OJF-ve shqiptare. Nga rezultatet e sondazhit rezulton se kohëzgjatja e kontratës së punës bazohet kryesisht në kohëzgjatjen e projekteve.



Kontrata më e zakonshme e punës që aplikohet nga kampioni për stafin me kohë të plotë është kontrata një vjeçare, 54% e tyre. Pjesa tjetër e organizatave aplikojnë kontratat e punës me kohë të papërcaktuar (30 %), gjashtë mujore (13%) dhe tre mujore (2.5%).

Për stafin me kohë të pjesshme, situata paraqitet ndryshe. Vendin e parë ndër alternativat e zgjedhura nga të intervistuarit e zë kontrata me kohëzgjatje të papërcaktuar (45%), e pasuar nga kontrata një vjeçare (27%). Pjesa tjetër aplikojnë kontrata gjashtë mujore dhe tre mujore të punës.

Meqenëse në vlerësimin tonë jemi të interesuar veçanërisht për kapacitetet e organizatave që janë përfshirë në fushata apo në aktivitete antikorrupsion si dhe në proceset elektorale, le të shohim se cila është gjendja e stafit me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme në këto organizata (Grafiku 9 dhe 10).



Në Grafikon 9 dhe 10, që reflektojnë gjendjen e stafit në organizatat që kryejnë aktivitete antikorrupsion (67% e OJF-ve), vërejmë diferenca përsa i përket numrit të stafit të punësuar me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. Organizatat e përfshira në fushata antikorrupsion, preferojnë që të punësojnë më tepër staf me kohë të pjesshme, dhe ky numër në 25% të tyre shkon edhe më shumë se dhjetë. I njëjti fenomen vihet re edhe në organizatat e përfshira në proceset elektorale, siç shihet edhe në Grafikon 11 dhe 12. Ky fenomen mund të lidhet me burimet e pakta financiare të organizatave, por edhe me profilin e punës së punonjësve me kohë të pjesshme, të cilët në shumicën e rasteve mund të jenë ekspertë të fushave të ndryshme që u nevojiten organizatave në momente të caktuara të fushatës antikorrupsion ose të procesit elektorale.



Vullnetarët: Puna vullnetare është një praktikë e njohur për organizatat në mbarë botën, veçanërisht për ato që merren me advokasi ku kapacitetet njerëzore janë shumë të rëndësishme. Organizatat shqiptare e kanë përqafuar këtë praktikë dhe kjo vërtetohet edhe nga të dhënat e sondazhit, ku përafërsisht 80% e organizatave të intervistuar i përfshijnë vullnetarët në aktivitetet e tyre dhe numri i vullnetarëve varion nga 1-1500 vullnetarë. Këto të dhëna janë të vlefshme edhe për organizatat e përfshira në proceset zgjedhore.

Në pamje të parë këto shifra të krijojnë përshtypjen e një zhvillimi pozitiv në drejtimin e përfshirjes së vullnetarëve në fushatat e advokasisë, por fakti që 30% e tyre pohojnë se kanë vetëm 10-20 vullnetarë lë për të dëshiruar.

Nëse i referohemi kontributit të vullnetarëve përkundrejt buxhetit vjetor të organizatës, vëmë re që vetëm 34% e tyre e vlerësojnë me një vlerë më shumë se 10% të buxhetit. Këto shifra tregojnë se pjesa më e madhe e OJF-ve të intervistuar nuk kanë kapacitete për të planifikuar kontributin/punën e vullnetarëve në terma financiarë. Ndërkohë, është i njohur fakti që vullnetarët kryejnë shumë detyra brenda organizatës dhe roli i tyre është i rëndësishëm në përcaktimin e suksesit të fushatave të advokasisë.

Trainimi i stafit. Një element tjetër i rëndësishëm në suksesin e punës së organizatave që punojnë në fushën e advokasisë, është dhe investimi i organizatës në ngritjen e kapaciteteve të stafit, për t'iu përgjigjur më mirë nevojave dhe kërkesave të punës në advokasi.


Shumica e organizatave të intervistuar shprehen se kanë marrë pjesë në trainime për çështje të tilla, si: planifikim strategjik, manaxhim financiar, aftësi komunikimi, manaxhim konflikti. Ndërkohë që, për çështje që lidhen me hartimin dhe implementimin e fushatave të advokasisë, numri i përgjigjeve pozitive është i vogël, më pak se gjysma e të intervistuarve. Edhe pse organizatat në sondazh punojnë në fushën e advokasisë, nga këto të dhëna rezulton se një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë mangësi teorike dhe praktike në fushën e advokasisë. Ky realitet lidhet me dy arsye kryesore:

1. Orientimi i sektorit të OJF-ve drejt punës në advokasi vetëm vitet e fundit;
2. Mungesa e planifikimit për të investuar në forcimin e kapaciteteve të stafit për t'u përfshirë në fushata advokacie.

V. b. 3. Kapacitetet infrastrukturore

Kapacitetet infrastrukturore të organizatave shqiptare janë në nivele të ulëta, siç pohohet edhe nga vetë organizatat pjesëmarrëse në sondazh. Shumica e tyre, 59.5%, i vlerësojnë kapacitetet infrastrukturore nën nivelin mesatar, në një shkallë vlerësimi nga 1-5, ku 1 është “dobët” dhe 5 “shumë mirë”. Përveç tyre, 30% e OJF-ve i vlerësojnë kapacitetet e tyre infrastrukturore si të dobëta dhe shumica e tyre janë jashtë Tirane.

Nga Grafiku 13 shihet qartë diferenca e kapaciteteve të organizatave nga Tirana me ato nga rrethet e tjera. Këto diferenca përforcojnë edhe njëherë avantazhin e organizatave nga Tirana për t'u përfshirë në aktivitete me karakter advokues.



V. c. Qëndrueshmëria financiare

Përveç burimeve njerëzore, organizatat që punojnë në fushën e advokasisë, si të gjitha organizatat e tjera të sektorit, kanë nevojë për burime financiare për të implementuar me sukses fushatat në mbrojtje të çështjeve publike. Ndërkohë që burimet financiare ndikojnë në suksesin e fushatave të advokasisë, ato janë kthyer në një faktor pengues për OJF-të e përfshira në fushata advokacie, për shkak të mungesës së fondeve, si dhe të kapaciteteve të ulëta manaxhuese. Më poshtë, le të shohim se si pasqyrohet gjendja reale e kampionit të përfshirë në aktivitete advokacie, përse i përket kapaciteteve financiare.

V. c. 1. Sistemet financiare dhe kapaciteti manaxhues

Nga 131 organizata të intervistuar, 70% e tyre deklarojnë se kanë adaptuar sisteme të manaxhimit financiar të cilat konsistojnë kryesisht në përmbledhje të raportit financiar sipas burimeve, rregulla financiare, raport vjetor financiar dhe buxhet vjetor të organizatës. Duhet theksuar që kjo përqindje tregon rritje të kapaciteteve të sektorit përse i përket manaxhimit financiar. Bazuar në vlerësimin e nevojave të sektorit në vitin 2001, statistikatat tregojnë që numri i organizatave me sisteme financiare të ngritura dhe që hartojnë raport financiar vjetor, tashmë është 50 % më i lartë.


Ndërkaq, 30 % e këtyre organizatave e botojnë raportin financiar.

Nga analiza e të dhënave vihet re se botimi i raportit financiar si një tregues i rëndësishëm kapaciteti dhe transparence, ka marrë zhvillim në rritje veçanërisht pas vitit 2002, kohë në të cilën vihet re një dyfishim i numrit të organizatave që botojnë raportet financiare. Vëllimin

më të madh në këtë grup e zënë organizatat të cilat janë krijuar në intervalin kohor 1996-2000. Duke patur parasysh gjithë zhvillimet në sektorin jofitimprurës kjo mund të ketë lidhje me rritjen dhe konsolidimin e kapaciteteve të OJF-ve shqiptare, rritjen e kërkesës së llogarisë nga ana e komunitetit të donatorëve në kushtet e rritjes së konkurrencës dhe të zvogëlimit të burimeve financiare.

V. c. 2. Burimet e financimeve për vitin 2004

Burimi kryesor i financimit të OJF-ve shqiptare mbeten donatorët dhe këtë fakt e tregon Grafiku 14 ku shihet qartë diferenca e madhe e përqindjes së të ardhurave që vijnë nga donatorët, në raport me burimet e tjera.



Ndonëse në përqindje të ulët, është inkurajues fakti që po rritet prania e sektorit të biznesit si kontribues por edhe si përfitues i shërbimeve të ofruara nga organizatat.

Një kuadër ligjor i cili do të ofronte lehtësira financiare më të mëdha për sektorin e biznesit në rastin e financimit të OJF-ve, do të siguronte një mbështetje më të madhe dhe të qëndrueshme për sektorin e OJF-ve.


Në sektorin e OJF-ve, shoqatat janë të vetmet organizime me anëtarësi që në parim duhet të mbështeten në kuotat e anëtarësisë. Megjithatë kjo pjesë e sektorit vazhdon të vuajë nga lidhjet e dobëta me anëtarësinë, e shprehur kjo në përqindjen e ulët të mbledhjes së kontributeve nga anëtarët. Nga 90 shoqata të intervistuar vetëm 76% e tyre pohojnë se arrijnë të mbledhin kuotat e anëtarësisë në masën 10%-100%, dhe prej tyre vetëm 34% arrijnë të mbledhin kuotat e anëtarësisë në një masë 90%-100%.

Nga të dhënat shikojmë se përqindja e të ardhurave nga shërbimet është e papërfillshme në totalin e përgjithshëm të buxhetit për vitin 2004, ndonëse duhet theksuar fakti që një pjesë e organizatave që punojnë në fushën e advokatisë për shkak të misionit të tyre (watchdog, monitorim zgjedhjes) do të mbeten për një kohë më të gjatë dhe në vëllim financimi më të madh të varura nga financimet e donatorëve.

Në kushtet kur sektori i OJF-ve vazhdon të mbetet i varur pothuajse plotësisht nga financimet e donatorëve, dy ndër elementët që do të kontribuonin në qëndrueshmërinë financiare të sektorit janë: (1) sigurimi i të ardhurave nga ofrimi i shërbimeve përkundrejt pagesës për publikun dhe shtetin dhe (2) larmia e donatorëve.

Siç duket qartë nga sondazhi, sektori i OJF-ve vazhdon të tregojë mangësi në drejtim të planifikimit strategjik të ofrimit të shërbimeve përkundrejt pagesës. Ndonëse sektori ka arritur suksesshëm të shtojë larminë e shërbimeve që ofron, vërehet nevoja për ngritjen e kapaciteteve të brendshme që do të mundësonin ofrimin e shërbimeve cilësore për publikun. Jo rrallë ndodh që shërbimet e ofruara nuk janë në përputhje me misionin e organizatës apo statusin e tyre jofitimprurës. Shërbime të tilla variojnë nga shërbime fotokopje, faksi, kurse kompjuteri, kurse të gjuhëve të huaja, etj. Përjashtim nga ky fenomen bëjnë organizatat që ofrojnë shërbime për biznesin, në të cilat vihet re një konsistencë midis misionit dhe shërbimeve që ofron organizata.


Në kuadrin e bashkëpunimit të sektorit të OJF-ve me shtetin, numrin më të madh të kontratave të përfituara nga OJF-të e zënë qendrat dhe fondacionet ku rreth 25 % e tyre kanë përfituar të paktën një kontratë me shtetin për vitin 2004. Shërbimet kryesore të ofruara në kuadrin e këtyre kontratave lidhen me hartimin e strategjive kombëtare dhe rajonale si dhe ofrimin e shërbimeve sociale për grupet në nevojë. Buxheti i këtyre kontratave varion nga 60\$ - 25.000 \$.



Larmia e financimeve nga donatorë të ndryshëm, është element i qëndrueshmërisë sepse shpreh besueshmërinë dhe kapacitetin e një organizate. Ky element kontribuon drejtpërdrejt në pavarësinë e organizatës për të përmbushur misionin e saj, përtej interesave të ngushta të donatorëve.

Në këtë drejtim vërehet një përmirësim i kapaciteteve të sektorit të OJF-ve dhe një pavarësi e tyre nga donatorët, pasi rezulton se 80% e OJF-ve janë financuar nga më shumë se një donator për periudhën 2001-2004.

Kjo përqindje bëhet edhe më domethënëse, pasi 62% e OJF-ve të intervistuar pohojnë se janë financuar nga 2-6 donatorë gjatë periudhës 2001-2004, siç vërehet edhe nga Grafiku 16.



V. c. 3. Pengesat në sigurimin e fondeve

Një ndër pengesat kryesore të identifikuar nga 64% e OJF-ve pjesëmarrëse në sondazh, rezultojnë të jetë politika e donatorëve. Kjo lidhet me orientimin e ri të financimeve nga ana e donatorëve pas vitit 2001 në mbështetje të aktivitetit advokues dhe lobues të sektorit. Në kushtet kur një pjesë e konsiderueshme e OJF-ve shqiptare ishte orientuar drejt ofrimit të shërbimeve sociale me një shkallë të lartë specializimi, ky ndryshim e gjeti sektorin të papërgatitur dhe një pjesë të tij “të paligjshëm” për hatër të misionit, për të përfituar nga mbështetja financiare e donatorëve.

Në kushtet e reduktimit të fondeve nga ana e donatorëve për sektorin e OJF-ve, lindi nevoja për tregues të qartë qëndrueshmërie dhe transparence të reflektuar këto në kriteret më të forta financimi. I ndodhur përpara një presioni të tillë nga njëra anë dhe kapaciteteve të dobëta institucionale nga ana tjetër, sektori filloi t’i shihte këto ndryshime në politikat e donatorëve si një pengesë për të tërhequr financime.

Pothuajse gjysma e OJF-ve të intervistuar (43% e OJF-ve) konsiderojnë si një tjetër pengesë të rëndësishme të punës së tyre, reduktimin e financimeve.

Të tjera pengesa sipas rëndësisë renditen mungesa e ekspertizës në ngritjen e fondeve (16% e OJF-ve) si dhe ligjet dhe rregulloret (16% e OJF-ve).

V. d. Kapacitetet advokuese

Advokasia është një proces që synon bindjen e vendimmarrësve për të “votuar” pro çështjes me të cilën punohet, me qëllim vendosjen dhe zbatimin e ligjeve dhe politikave që do të krijojnë një shoqëri të drejtë dhe barabartë. Për të realizuar këtë mision, organizatat shqiptare

që angazhohen në fushata advokacie dhe që janë në fokus të këtij vlerësimi, duhet domosdoshmërisht të zhvillojnë disa kapacitete që i bëjnë të suksesshme këto fushata. Disa prej këtyre kapaciteteve, që do të analizohen më poshtë në raport, janë:


- Komunikimi me vendimmarrësit
- Ndërtimi i rrjeteve dhe koalicioneve me organizata të tjera
- Mobilizimi dhe mbështetja e gjerë nga ana e qytetarëve
- Lobimi

V. d. 1. Komunikimi me vendimmarrësit

Një ndër elementët që përcakton pjesëmarrjen dhe suksesin e shoqërisë civile në garantimin dhe promovimin e një kuadri ligjor në shërbim të interesave të publikut, është aksesin në vendimmarrje në nivel qendror dhe në nivel lokal.


Kjo pasqyrohet së pari, në ekzistencën e një kuadri ligjor që mundëson pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje, i cili sipas sondazhit rezultoi i favorshëm për OJF-të e intervistuarat. Nga të dhënat e sondazhit rezultoi se 68.5% e OJF-ve të intervistuarat nuk mendojnë se ka nevojë për ndryshime në legjislacion për të mundësuar pjesëmarrjen, përfshirjen, apo dhënien e mendimeve të tyre në nivelet vendimmarrëse.

Elementi i dytë që pasqyron aksesin në vendimmarrje lidhet me linjat e komunikimit me vendimmarrësit në nivel qendror dhe lokal. Nga sondazhi rezultoi se shumica e organizatave (85%) pohojnë se kanë linja të tilla komunikimi. Kryesisht, këto linja komunikimi funksionojnë më shumë në nivelin e *qeverisjes vendore* (79%) dhe shumë pak me nivelin *qendror* (ministri) dhe me *parlamentin* pavarësisht statusit të OJF-ve.




Natyrshëm puna e OJF-ve si një grupim që ka për mision primar shërbimin ndaj komunitetit, lidhet ngushtë me vendimmarrjen nga ana e pushtetit vendor si ofruesi kryesor i shërbimeve publike në nivelet më të afërta me qytetarët.

Gjetjet e mësipërme janë të vlefshme edhe për komunikimin e organizatave sipas ndarjes gjeografike. Ndryshimi që vihet re në këtë aspekt, qëndron në komunikimin më të madh që kanë organizatat nga Tirana me nivelin qendror (ministrinë dhe parlamentin), në krahasim me organizatat nga rrethet.



Nëse u referohemi aktiviteteve që OJF-të realizojnë në kuadër të punës së tyre në advokasi, duket qartë që ato i përqendrojnë më tepër përpjekjet e tyre në mobilizimin e komunitetit në përkrahje të iniciativave me karakter advokues, i pasuar nga ndryshimi i politikave qeverisëse. Për realizimin e këtyre të fundit, nevojitet siç theksohet edhe nga OJF-të e interesuara, një nivel më i lartë komunikimi me qeverisjen qendrore (Grafiku 19).



Linjat e komunikimit që përdorin OJF-të me vendimmarrësit, variojnë që nga takime joformale, të bazuara shpesh në njohjet personale të drejtuesve të organizatave me politikë-bërës të veçantë, që është më tepër një fenomen që ndodh me organizatat që operojnë jashtë Tiranës, tek takimet dhe bashkëpunimet për projekte të përbashkëta, asistencë dhe rekomandime në hartimin e politikave, strategjive apo ligjeve e deri tek komunikimet me karakter lobues për çështje të veçanta. Ndër to, forma më e preferuar dhe më shpesh e përdorur nga OJF-të rezultojnë të jetë takimi, e përmendur nga 92% e organizatave të intervistuar.

Suksesi me vendimmarrësit nuk qëndron vetëm në sasinë apo linjat e ndryshme të komunikimit, por edhe në vlerësimin e rëndësisë së tyre nga ana e OJF-ve. Komunikimi vlerësohet pozitivisht nga shumica e organizatave që kanë komunikim me politikë-bërësit, pasi 65% e tyre e vlerësojnë në një nivel të kënaqshëm në një shkallë vlerësimi nga 1 në 5, ku 1 nënkupton aspak i kënaqur dhe 5 shumë i kënaqur. Ndërsa 37% e OJF-ve të intervistuar e vlerësojnë relativisht të kënaqshëm komunikimin me vendimmarrësit.

Megjithëse rezultatet në fushën e komunikimit me vendimmarrësit duken inkurajuese, përsëri kampioni mbetet kritik për sa i përket marrëdhënieve dhe komunikimit me vendimmarrësit në nivel qendror e lokal. Disa nga kërkesat e tyre ndaj qeverisë, për t'i bërë më të efektshme përpjekjet e OJF-ve në fushën e advokatisë, janë si më poshtë:

- Një qeveri më transparente dhe më të hapur ;
- Përmirësim të marrëdhënieve të sektorit të OJF-ve me të gjitha nivelet vendimmarrëse;
- Më shumë përgjegjësi nga ana e qeverisë;
- Qeverisje më aktive dhe më të hapur për bashkëpunime dhe partneritete me sektorin e OJF-ve;
- Më shumë njohje dhe vlerësim të punës së OJF-ve nga ana e vendimmarrësve.

V. d. 2. Përfshirja e anëtarëve në fushatat e advokatisë

Një tjetër element shumë i rëndësishëm në fushatat e advokatisë është përfshirja e anëtarëve dhe e mbështetësve të organizatës në aktivitetet që realizohen në kuadër të këtyre fushatave. Fushatat e suksesshme të advokatisë karakterizohen nga aktivitete masive publike si mitingje, manifestime, protesta paqësore që kërkojnë mobilizim të qytetarëve.


Shumica e OJF-ve të intervistuar (78.5%), pohojnë se i përfshijnë anëtarët dhe mbështetësit e tyre në aktivitetet e advokatisë dhe ky duket një tregues pozitiv. Përgjigjet lidhur me specifikimin e mënyrave të përfshirjes së anëtarëve tregojnë për një kuptim jo të drejtë nga ana e OJF-ve të intervistuar lidhur me përfshirjen e publikut në fushatat e advokatisë. Mënyrat e përfshirjes, të përmendura nga OJF-të e intervistuar janë si vijon:

- Përfshirje në aktivitete, trainime, seminare, konferenca të ndryshme;
- Përfshirje në zbatim projektsh dhe të planeve të punës së organizatës;
- Përfshirje nëpërmjet vlerësimit të nevojave të komunitetit, etj.

V. d. 3. Formimi i koalicioneve për promovimin e interesave të përbashkëta

Praktikat bashkëkohore në fushën e advokatisë e vënë theksin gjithnjë e më tepër tek advokasia me pjesëmarrje, që do të thotë bashkëpunim, partneritet, koordinim me organizata dhe aktorë të tjerë me interes të përbashkët. Në këtë drejtim vihet re një zhvillim pozitiv brenda sektorit të OJF-ve shqiptare. Kështu 90% e OJF-ve të intervistuar janë përfshirë në koalicione për të promovuar një çështje me interes të përbashkët.

Edukimi qytetar renditet i pari ndër çështjet për të cilat organizatat janë bashkuar në koalicione. Ky rezultat mund të konsiderohet i pritshëm, nëse kujtojmë se shumica e OJF-ve (75%) të përfshira në procesin zgjedhor, realizojnë aktivitete që lidhen me edukimin e votuesve. Një konsistencë tjetër që vihet re nga përgjigjet e kampionit mbi këtë çështje është se pothuajse të njëjtat organizata që përfshihen në koalicione për hartimin e rekomandimeve ligjore, përfshihen edhe në propozime/lobim për ndryshime legjislative. Ky fakt tregon që puna e OJF-ve nuk mbetet vetëm në nivelin e hartimit, por përpjekjet e tyre shkojnë edhe më tej me kërkesat për aprovimin e projekt-ligjeve nga politikë-bërësit, siç shihet edhe nga Grafiku 20.



Efektivitetin e koalicioneve, OJF-të shqiptare e vlerësojnë relativisht të suksesshëm. Nga të gjitha OJF-të e intervistuar me eksperiencë të mëparshme pune në koalicion, 46.5% e tyre i vlerësojnë efektive këto eksperiencë, në një shkallë vlerësimi nga 1 në 5, ku 1 nënkupton “aspak efektive” dhe 5 “shumë efektive”. Janë vetëm 13.5% e organizatave që kanë përjetuar eksperiencë negative nga pjesëmarrja në koalicione për promovimin e çështjeve të përbashkëta, duke i vlerësuar ato si jo efektive.

Edhe pse nga përgjigjet e organizatave të intervistuar rezultoi një vlerësim i tillë, kërkesa për koalicionet efektive ndërmjet OJF-ve, mbetet një ndër alternativat më të zgjedhura nga OJF-të (66%), kur ato pyeten mbi nevojat për t'i bërë efektive përpjekjet e tyre advokuese. Ky fakt, në mënyrë indirekte tregon se koalicionet në të cilat janë përfshirë OJF-të, nuk kanë arritur rezultatet e pritshme në fushatat e advokatisë ose nevoja për koalicionet të efektshme në këtë fushë është ende e lartë.

V. d. 4. Lobimi

Procesi i lobimit është një ndër elementët kryesorë të fushatës së advokatisë që ndikon në suksesin apo mosesuksesin e saj. Po t'u referohemi të dhënave të sondazhit vihet re që 87% e organizatave shqiptare janë të familjarizuara me konceptin e lobimit dhe ndihen komfort me pjesëmarrjen në një proces lobimi.

Por ndërkohë që një përqindje kaq e lartë e kampionit pohon se është e familjarizuar me konceptin e lobimit, shumë pak prej tyre pohojnë se ndihen të aftë për t'u përfshirë në një proces të tillë, pasi nuk kanë kapacitetet e nevojshme dhe eksperiencën të mëparshme të suksesshme në mbrojtjen e çështjeve apo zbatimin të ligjeve në shërbim të komunitetit.

Mungesën e kapaciteteve e përforcon edhe fakti se trainimet në fushën e lobimit për t'i bërë efektive përpjekjet e tyre në fushën e advokatisë mbeten një nevojë e shumicës së organizatave të intervistuar. Nga 62% e OJF-ve që kanë identifikuar trainimet si nevojë për t'i bërë më efikase përpjekjet e tyre në fushën e advokatisë, pothuajse të gjitha kanë specifikuar temën e advokatisë dhe lobimit si ndër më të kërkuarat.

V. e. Imazhi publik

Imazhi i OJF-ve në publik, është një tjetër aspekt shumë i rëndësishëm që ndikon në punën dhe në suksesin e fushatave të advokatisë të ndërmarrura nga organizatat shqiptare. Jo rrallë herë, OJF-të shqiptare kanë vuajtur nga mungesa e një imazhi të konsoliduar si sektor i tretë në shërbim të komunitetit.

Kodi etik, qëndrimi i qeverisë ndaj sektorit të OJF-ve dhe marrëdhëniet me median janë tre elementë që lidhen ngushtë dhe përcaktojnë imazhin që do të kenë OJF-të në sytë e publikut të gjerë dhe që do të analizohen më poshtë në studim.

V. e. 1. Kodi i Etikës


Pothuajse të gjitha organizatat e intervistuar (98%) e shikojnë Kodin Etik si shumë të rëndësishëm për sektorin e OJF-ve. Një kod i tillë, siç theksohet edhe nga organizatat e intervistuar në sondazh, do t'i shërbejë sektorit si në aspektin e përmirësimit të performancës së OJF-ve, të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, por edhe në rritjen e besimit të publikut ndaj sektorit të OJF-ve.

Ndërkohë në Shqipëri prej disa kohësh, kanë filluar përpjekjet për hartimin e një Kodi Etik për OJF-të, mbi bazën e të cilit duhet të funksionojnë të gjitha organizatat.

V. e. 2. Qëndrimi i qeverisë ndaj sektorit të OJF-ve


Sjellja e qeverisë kundrejt sektorit të OJF-ve që punon në fushën e advokatisë, konsiderohet prej kampionit të intervistuar si një faktor lehtësues ose pengues në disa raste, në suksesin e fushatës. Në një shkallë vlerësimi nga 1 në 5, ku me 1 vlerësohen marrëdhëniet konfliktuale dhe me 5 marrëdhëniet mbështetëse, sjellja e qeverisë konsiderohet nga OJF-të si jo mbështetëse, madje tenton të jetë konfliktuale. Shumica e organizatave e vlerësojnë sjelljen e qeverisë jo të mirë (48%) dhe jo ndihmuese (32%). Vlen të përmendet fakti se asnjë nga organizatat e intervistuar nuk e kanë vlerësuar mbështetëse sjelljen e qeverisë shqiptare ndaj sektorit të OJF-ve.

Të dhënat e sondazhit që i referohen shpërndarjes gjeografike të OJF-ve, tregojnë që organizatat të cilat e vlerësojnë sjelljen e qeverisë si më negative, janë në përqindjen më të madhe nga veriu i Shqipërisë. Kjo situatë shpjegon disi edhe angazhimin në nivele të ulëta të organizatave nga veriu në fushatat e advokatisë. Organizatat nga jugu, qendra dhe nga Tirana vlerësojnë pothuajse në nivele të njëjta sjelljen e qeverisë ndaj sektorit, siç shihet edhe nga Grafiku 21.




Pavarësisht vlerësimit jo pozitiv që i bën kampioni sjelljes së qeverisë ndaj sektorit të OJF-ve, të dhënat e sondazhit tregojnë se OJF-të e intervistuar janë aktive në përfshirjen e tyre në vendimarrjen vendore e qendrore.

Pjesëmarrje më e madhe në vendimmarrjen publike rezulton në nivel vendor, e shprehur kjo me pjesëmarrjen në mbledhjet e Këshillit Bashkiak.




Përsa i përket niveleve të pjesëmarrjes sipas ndarjes gjeografike të organizatave të intervistuar, nga Grafikët 22 e 23 shihet një ndryshim midis organizatave të Tiranës dhe atyre jashtë Tiranës. Organizatat nga Tirana përfshihen më shumë në forumet qendrore në nivel parlamentar, ministror apo forume kombëtare, ndërsa në nivel vendor janë organizatat nga jugu ato që marrin më tepër pjesë në vendimmarrjen lokale nëpërmjet pjesëmarrjes në mbledhjet e Këshillit Bashkiak. Organizatat nga Tirana çuditërisht përfshihen më tepër në mbledhjet e Këshillave të Komunave sesa ato të Këshillit Bashkiak.



Pjesëmarrja jo gjithmonë është barazi me efektivitet dhe kjo vërtetohet edhe nga përgjigjet e pyetjes që lidhet me efektivitetin që ka patur pjesëmarrja në këto forume në influencimin e politikave publike, ku më shumë se gjysma e organizatave (58%) e vlerësojnë jo efektive pjesëmarrjen e tyre, në një shkallë vlerësimi 1-5, ku 1 nënkupton “aspak efektive” dhe 5 “shumë efektive”. Ky fakt lidhet me vlerësimin jo pozitiv të OJF-ve të intervistuar ndaj sjelljes së qeverisë shqiptare ndaj sektorit të OJF-ve, të analizuar më sipër.

V. e. 3. Marrëdhëniet me Median


Media është një mjet i rëndësishëm në ndërtimin e imazhit të sektorit të OJF-ve në publikun e gjerë. Bazuar në eksperiencat e tyre me median, pjesa më e madhe e organizatave të intervistuar i vlerësojnë pozitivisht marrëdhëniet me median. Në shkallën e vlerësimit nga 1 në 5 ku 1 nënkupton “aspak të aksesueshme” dhe 5 “shumë të aksesueshme, 82.5% e kamponit e vlerësojnë median relativisht të aksesueshme nga ana e tyre.



Arsyet që rendisin organizatat për një akses të tillë janë të ndryshme dhe lidhen kryesisht me aktivitetet dhe punën e organizatave që tërheqin vëmendjen e medias, veçanërisht të medias lokale. Disa prej arsyeve të cituara prej të intervistuarve renditen si më poshtë:

- “Aktivitetet janë reflektuar në mënyrë të drejtë”;
- “Kemi patur shumë akses në media, vetëm këtë vit janë botuar 260 artikuj në shtypin e shkruar”;
- “Janë pjesëmarrës dhe të ftuar në shumë programe tonat, deklaratat botohen rregullisht”;
- “Janë afruar vetë për të ndjekur aktivitetet e qëndrës”;
- “Është pjesë e punës së OJF-së sonë dhe kemi marrëdhënie bashkëpunimi të përhershme”;
- “Kemi përdorur mjete tërheqëse për të afruar mediat”;

- “Ka qenë mbështetëse, sidomos media lokale gjithmonë prezente në aktivitetet e shoqatës”.



Vetëm 14% e OJF-ve të intervistuar e konsiderojnë median të pa aksesueshme nga ana e tyre. Arsyet që shprehin këto organizata janë si më poshtë:

- Mundësitë e pakta financiare të OJF-ve për të përballuar shërbimet me pagesë që ofron media;
- Prioritetet e medias nuk përputhen ose bien ndesh me aktivitetet e organizatës;
- Mungesa e besimit për pasqyrimin me vërtetësi të informacionit nga media.

Teknikat e përdorura nga OJF-të e intervistuar për të komunikuar në media janë nga më të larmishmet dhe përfshijnë si median e shkruar ashtu edhe atë elektronike. Teknikat më të përdorura janë si më poshtë:

- Intervista për median; 79 % e kampionit
- Shkrimi dhe publikimi i artikujve në gazeta apo revista; 76 % e kampionit
- Kanë zhvilluar programe televizive; 75.5 % e kampionit
- Deklaratat për shtyp; 74 % e kampionit
- Zhvillimi i programeve nga vetë organizata në radio; 46 % e kampionit
- Blerja ose përgatitja e reklamave; 43 % e kampionit
- Kanë patur në pronësi ose që kanë drejtuar një gazetë ose revistë; 28 % e kampionit

Vetëm 25% e OJF-ve të intervistuar kanë pohuar që kanë faqe në internet. Ky fakt tregon se përdorimi i teknologjive të informacionit nga OJF-të shqiptare, mbetet në nivele të ulëta.

KONKLUZIONE

- Shoqëria civile në Shqipëri ka filluar të bëhet prezente në procese të rëndësishme të zhvillimit të demokracisë në vend, siç janë proceset zgjedhore dhe fushatat antikorrupsion, por masiviteti dhe përhapja gjeografike e kësaj prezence mbetet ende në nivele të ulëta;
- Rezultatet e fushatave të advokasisë të implementuara këto vite, nuk janë aq pozitive dhe nuk mund të vlerësohen si të suksesshme në realizimin e qëllimeve të tyre;
- Organizatat shqiptare në përgjithësi, veçanërisht ato jashtë Tirane, megjithë zhvillimet e viteve të fundit, nuk kanë kapacitetet e duhura organizative në aspektin financiar, njerëzor dhe infrastrukturor për të ndërmarrë dhe për të realizuar fushata të suksesshme advokacie në mbrojtje të çështjeve publike;
- Burimi kryesor i financimeve të OJF-ve shqiptare vazhdojnë të mbeten donatorët e huaj;
- Shoqatat, të vetmet organizime me anëtarësi, vazhdojnë të vuajnë nga lidhjet e dobëta me anëtarësinë, e shprehur kjo në përqindjen e ulët të mbledhjes së kontributeve, që do të ndikonte në qëndrueshmërinë dhe pavarësinë e tyre financiare;
- Sektori i OJF-ve vazhdon të tregojë mangësi në drejtim të planifikimit strategjik për ofrimin e shërbimeve përkundrejt pagesës, që do të siguronte një qëndrueshmëri dhe pavarësi të sektorit;
- Një kuadër ligjor i cili do të ofronte lehtësira financiare më të mëdha për sektorin e biznesit në rastin e financimit të OJF-ve, do të siguronte një mbështetje më të madhe dhe të qëndrueshme për sektorin e OJF-ve;
- Eksperiencat e punës në koalicione, reflektojnë nevojën e OJF-ve për ngritjen e koalicioneve efektive brenda sektorit të OJF-ve, për t'i bërë të suksesshme fushatat e advokasisë;
- Kodi Etik vlerësohet si një ndër elementët kryesorë që do të ndikojë në përmirësimin e imazhit të sektorit të shoqërisë, jo vetëm tek publiku, por edhe tek sektorët e tjerë siç janë shteti dhe biznesi;

- Vërehet një rritje e nivelit të komunikimit të OJF-ve me vendimmarrësit dhe rritje e pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje, veçanërisht në nivel vendor për të ndikuar hartimin dhe implementimin e politikave publike. Megjithatë sjellja e qeverisë ndaj sektorit të shoqërisë civile, ende nuk vlerësohet si mbështetëse nga OJF-të;
- Trainimet mbeten një kërkesë e vazhdueshme e OJF-ve shqiptare për rritjen e kapaciteteve të stafit dhe zhvillimin e organizatës, veçanërisht në fushën e advokasisë dhe lobimit;
- OJF-të e kuptojnë dhe e vlerësojnë rolin e medias në ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e opinionit publik duke e bërë atë pjesë të aktiviteteve të tyre. Por, mungesa e hapësirës mediatike e rregulluar nëpërmjet *Njoftimeve në Shërbim të Publikut* për bërjen publike apo promovimin e veprimtarisë së sektorit si dhe në disa raste politizimi i medias, e limiton deri diku këtë akses, veçanërisht për organizatat me kapacitete dhe burime të limituara;
- Organizatat që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në Tiranë, kanë në të gjitha aspektet kapacitete më të mëdha krahasuar me organizatat jashtë Tiranës.

REKOMANDIME

- Sektori i OJF-ve duhet të vazhdojë iniciativën e një grupi të OJF-ve, për zhvillimin e Kodit të Etikës së OJF-ve, duke promovuar përfshirjen e sa më shumë OJF-ve në proces, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit të organizatave kombëtare mbi rëndësinë e besueshmërisë, përgjegjshmërisë dhe transparencës ndaj publikut.
- Duke patur parasysh imazhin jo të shëndetshëm publik që sektori gëzon nga njëra anë dhe detyrimet që sektori ka kundrejt shtetit nga ana tjetër është mëse e domosdoshme zhvillimi nga ana e sektorit e mekanizmave që rrisin transparencën ndaj shtetit, ndaj publikut dhe përfituesve të tjerë të shërbimeve të tij. Hapi i parë në këtë drejtim do të ishte bërja publike e aktivitetit dhe situatës financiare nga ana e OJF-ve.
- Programet e trainimit dhe të asistencës teknike për sektorin e OJF-ve që vepron në fushën e demokracisë (veçanërisht OJF-të jashtë Tirane) duhet të fokusohen në transmetimin e njohurive dhe aftësive për rritjen e kapaciteteve advokuese të tyre, veçanërisht mbi çështjet e qeverisjes me pjesëmarrje, teknikat e influencimit të politikave qeverisëse dhe monitorimin e shërbimeve të qeverisë.
- Duke qenë se trainimi dhe asistenca në forcimin e kapaciteteve të manaxhimit financiar dhe të gjenerimit të të ardhurave mbetet një nevojë e vazhdueshme për sektorin, vet-financimi dhe gjenerimi i të ardhurave duhet të jenë pjesë e programit të trainimit në Manaxhim financiar, veçanërisht për OJF-të jashtë Tirane. Trainimet në Manaxhim financiar duhet të ndiqen nga asistencë teknike individuale për elementë specifike të sistemit të manaxhimit financiar.
- Monitorimi efektiv i performancës së qeverisë kërkon rritjen e bashkëpunimit dhe institucionalizimin e marrëdhënieve OJF - Qeveri në formën e strukturave / forumeve të qeverisjes me pjesëmarrje.
- Ngritja dhe fuqizimi i marrëdhënieve OJF - Biznes kërkon ndërtimin e besimit midis sektorëve duke rritur nivelin e shkëmbimit të informacionit, cilësinë e shërbimeve të ofruara nga OJF-të si dhe rritjen e kapaciteteve të stafit të OJF-ve dhe Biznesit në organizimin e aktiviteteve me interes të përbashkët.

- Ngritja e forumeve të përbashkëta OJF - Media dhe rritja e kapaciteteve profesionale të përfaqësuesve të medias do të ndihmojë në fuqizimin e marrëdhënieve të sektorit me Median. Përfaqësuesit e medias mund të jenë pjesë e programeve të trainimit në: Advokasi dhe lobim, Negocim, Antikorrupsion etj.

VIII.1 Lista e qyteteve që përfshihen në secilën nga zonat gjeografike të përdorura në studim



Veri

Dibër

Has

Kukës

Mat

Pukë

Shkodër

Qendër

Durrës

Elbasan

Librazhd

Lushnje

Pogradec

Jug

Berat

Fier

Gjirokastër

Skrapar

Sarandë

Vlorë

Korcë

Kucovë

Përmet

VIII.2 Lista e organizatave pjesëmarrëse në studim

Agjencia e Mbështetjes së Infrastrukturës Vendore, Gjirokastër	Drejtesi dhe Paqe, Shkodër
Agjencia e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm (SEDA)	Edukatorët e Shëndetit, Përmet
Agjencia Rajonale e Zhvillimit, Berat	Edukatorët e të Drejtave të Njeriut, Vlorë
Agjencia Rajonale e Zhvillimit, Elbasan	Edukimi për Shoqërinë e Hapur
Agjencia Rajonale e Zhvillimit, Fier	Every Child
Agjencia Rajonale e Zhvillimit, Gjirokastër	Federata e Pyjeve dhe Kullotave Komunale, Qarku Dibër
Agjencia Rajonale e Zhvillimit, Tiranë	Fëmija në Fokus
Agjencia Rajonale e Zhvillimit, Vlorë	Fondacioni për Zgjidhjen e Konflikteve
AGRITRA-VIZION, Peshkopi	Fondacioni Shqiptar i Shoqërisë Civile
Albanian Students in Economics & Business Management (ASEB)	Qendra Rajonale e Zhvillimit dhe Monitorimit të Infrastrukturës, Mjedisit dhe Shoqërisë Civile, Gjirokastër
Albanian Youth Shakers	Forumi i OJF-ve, Dibër
Albarom, Durrës	Forumi i Pavarur i Gruas Shqiptare
Aleanca Gjinore për Zhvillim	Forumi i Rinisë Dibrane
Aleanca për Fëmijët	Forumi Shqiptar Social Ekonomik
Angazhimi Qytetar për Mirësi, Vlorë	Gjinokastra, Gjirokastër
Art, Kulturë, Sport (AKS), Librazhd	Gjirokastra Turistike
BLEKALB	Gora, Kukës
BYL - A (Mjaft)	Gruaja Beratase në Zhvillim
Çamëria, Vlorë	Gruaja Intelktuale Pogradecare
CARPE DIEM, Korçë	Gruaja Korcare
Co-plan, Instituti për Zhvillimin e Habitatit	

Gruaja Naftëtare në Fokusin e Zhvillimit, Kuçovë	Klubi Ekologjik, Fier
Gruaja në Zhvillim, Shkodër	Koalicioni Shqiptar Kundër Korrupsionit, Lushnjë
Gruaja për Veprim Global	Lidhja e Gazetarëve të Shqipërisë
Gruaja Rurale “Apolonia”, Fier	Linja e Këshillimit për Gratë dhe Vajzat, Shkodër
Gruaja Skraparese dhe Tranzicioni, Skrapar	Malteser-Ndihmon në Shqipëri, Shkodër
Gruaja tek Gruaja, Shkodër	Masmedia dhe Mjedisi
Gruaja Veprimtare e Gjirokastrës	Me Ju, për Ju Vajza!, Fier
Grupi Rinor i të Drejtave të Njeriut	Mediat e Lira
Iniciativa Ndaj Integritimit Rinor	Ndihmë për Fëmijët, Elbasan
Instituti i Kërkimeve Urbane	Nefreta, Vlorë
Instituti i Politikave Sociale	Oda Poetike, Pogradec
Instituti i Politikave të Aplikuara Gjinore	Prindi në Edukimin e Fëmijëve, Pogradec
Instituti i Studimeve Bashkëkohore	Qendra Avokatore për Gratë
Instituti për Bashkëpunim dhe Integritim	Qendra e Medias “Obelisk”, Gjirokastrë
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim	Qendra e Promovimit të Biznesit dhe Ekonomisë, Durrës
Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA)	Qendra e Punësimit të Grave, Pogradec
Instituti Privat Publik	Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integritimit
Integritimi dhe Zhvillimi Demokratik	Qendra e Studimeve Parlamentare
Integritimi Urban	Qendra e Studimeve Rurale dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm
Intelektualët e Rinj Shpresë (IRSH), SHkodër	Qendra Kombëtare Shqiptare për Studime Sociale
Juristët për të Drejtat e Njeriut, Kukës	Qendra për Kërkim dhe Zhvillim
KABAJA, Korçë	Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri
Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar	
Këshilli i Shoqatave të Shërbimeve Sociale, Durrës	
Klubi Ambientalist Pogradecar	

Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve	Shoqata në Dobi të Gruas Shqiptare, Elbasan
Qendra Psiko-Sociale “Vatra”, Vlorë	Shoqata në Mbrojtje të Personave me Aftësi të Kufizuar Mendore, Elbasan
Qendra Rajonale e Mjedisit	Shoqata në Mbrojtje të të Drejtave dhe Kulturës për Fëmijë, Kuçovë
Qendra Rinore “Trokitja”, Shkodër	Shoqata Patriotike e Vajzave dhe Grave Korcare “Marigo Pozia”
Qendra Shqiptare e Asistencës dhe Studimeve për Organet e Qeverisjes Vendore	Shoqata për Gratë dhe Fëmijët, Qendra Kombinat
Qeveria Studentore Shqiptare	Shoqata për Kulturë Demokratike
Rilindja e Apollonisë, Fier	Shoqata për Kulturë Demokratike, Dega Vlorë
Rrjeti Rinor Shqiptar për Integrim Europian	Shoqata për Kulturë Demokratike, Kucovë
Shoqata e Bletarëve, Mat	Shoqata për Kulturë Demokratike, Pukë
Shoqata e Fëmijëve dhe të Rinjve Jetimë, Korçë	Shoqata për Kulturën Vllahe, Gjirokastrë
Shoqata e Gazetarëve Profesionistë Jonianë, Sarandë	Shoqata për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Nxitjen e Turizmit, Gjirokastrë
Shoqata e Gazetarëve të Jugut, Gjirokastrë	Shoqata Rajonale e Prindërve, Fier
Shoqata e Gazetarëve të Vlorës	Të Drejtat e Gruas, Përmet
Shoqata e Grave “Jona”, Sarandë	Të gjithë Fëmijët Kanë të Njëjtën të Drejtë Njerëzore, Shkodër
Shoqata e Gruas, Librazhd	The Door, Shkodër
Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë	Turizmi dhe Mjedisi, Pogradec
Shoqata e Komunave të Shqipërisë	Unë Gruaja!, Pogradec
Shoqata e Konsumatorit Shqiptar	Unioni i Romëve të Shqipërisë-Amaro Drom
Shoqata e Mediave Lokale	Veriu në Zhvillim, Kukës
Shoqata e Përfitimit Fizik, Korçë	Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve
Shoqata Europiane e Studentëve të Ligjit	
Shoqata Kristiane e Grave Shqiptare (YËCA)	
Shoqata në Dobi të Gruas Shqiptare	